AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Nr. 609 Prot.
Datë, më 21.02.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1214/2 prot. Tiranë, më 20.2. 2025

Lënda: Dërgohet Urdhri nr. 71, datë 19.02.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 589, datë 16.10.2023 "Për miratimin e rregullores për përdorimin e sistemit të informacionit parauniversitar""

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Rruga "Aleksandër Moisiu"
Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë për njohje dhe zbatim "Urdhrin nr. 71, datë 19.02.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 589, datë 16.10.2023 "Për miratimin e rregullores për përdorimin e sistemit të informacionit parauniversitar"".

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT - TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr.214/1 Prot.

Tiranë, më 19.02.2025

URDHËR

Nr.71, datë 19.02.2025

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 589 DATË 16.10.2023 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRDORIMIN E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT PARAUNIVERSITAR"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar të nenit 5, të ligjit nr. 10 325, datë 23.9.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore", të vendimit nr. 742, datë 3.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP)", të vendimit nr. 621, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj" dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani",

URDHËROJ:

1. Në rregulloren e miratuar me urdhrin nr. 589 datë 16.10.2023 "Për miratimin e rregullores për përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar", bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

   a) Në nenin 2 dhe kudo në përmbajtje të rregullores shkurtimi "*DPAP Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar*" zëvendësohet me "*AKAP Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar*".

   b) Pika 3 nenit 3 të rregullores ndryshohet si më poshtë:
   "*3/1. **Punonjësi arsimor**-emri dhe mbiemri i drejtorit, mësuesit, oficerit të sigurisë dhe punonjësit të shërbimit psiko-social, të institucionit të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë, i cili është përgjegjës për nxënësin.*".

c) Në nenin 14 të rregullores, pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtje si më poshtë:
"6. Njofton individualisht për nxënësin ose në grup për të gjithë nxënësit e klasës në kujdestari, personin që ushtron përgjegjësinë prindërore.

d) Pas nenit 14 të rregullores, shtohet neni 14/1 me përmbajtje si më poshtë:

"Neni 14/1
Punonjësi i shërbimit psiko-social dhe oficeri i sigurisë

Punonjësi i shërbimit psiko-social dhe oficeri i sigurisë njofton individualisht ose në grup për të gjithë nxënësit e klasës nëpërmjet SMIP, personat që ushtrojnë përgjegjësitë prindërore, me anë të "Fletores së komunikimit digjital", për t'i informuar ata, në kohë reale për nxënësit sipas detyrave dhe fushës së përgjegjësisë që mbulojnë.".

e) Pas nenit 16 të rregullores, shtohet neni 16/1 me përmbajtje si më poshtë:

"Neni 16/1
Fletorja e komunikimit digjital

Fletorja e komunikimit digjital përmban informacion për nxënësin, të cilat i njoftohen personit që ushtron përgjegjësinë prindërore nëpërmjet SMIP, nga mësuesi kujdestar, punonjësi i shërbimit psiko-social dhe oficeri i sigurisë, të institucionit arsimor parauniversitar që ndjek nxënësi".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI

REPUBLIKA SHQIPËRISË - MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT - TIRANË